



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Kryesia e Kuvendit

P-015

Prishtinë, më 15 prill 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 15 PRILL 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq, Eqrem Kryeziu dhe Xhezair Murati, kurse munguan Nexhat Daci dhe Xhavit Haliti.

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Lutfi Haziri, Bojan Stojanoviç, dhe Zylfi Merxha, kurse munguan Lulzim Zeneli, Ardian Gjini dhe Ibrahim Makolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca ;

Nga Kabineti i Kryeministrit të Kosovës: Ramë Manaj,

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala;

Nga NDI: Rinor Beka dhe

Nga Zyra e Presidentit: Vjosa Osmani.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshmet të Kryesisë, mbajtur më 1 prill 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 prill 2008

Sabri Hamiti pati vërejtje në faqen 2 të procesverbalit dhe kërkoi që diskutimet e anëtarëve të Kryesisë lidhur me Projekt-Kushtetutën të evidencohen në formë përmbledhëse në procesverbal, kurse në transkript, në faqen 23, në pjesën e diskutimit të tij: “ Unë edhe dje isha **minuar** në mbledhjen e...”, fjala “minuar” të zëvendësohet me fjalën: “ i pranishëm”.

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 8 prill 2008, u miratua me këto vërejtje të Sabri Hamitit.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Kryesia, në mbledhjen e mëparshme kishte përgatitur propozimin e rendit të ditës për seancën plenare të 17 prillit 2008.

Ndërkohë, Presidentit i Kosovës, Fatmir Sejdiu, me një shkresë kishte kërkuar nga Kryesia që të thërrasë seancë të veçantë, ku Presidenti do ta mbajë një fjalim për gjendjen e përgjithshme në vend, kurse edhe Kryeministri, po ashtu me një shkresë kishte kërkuar nga Kryesia që të thërrasë mbledhjen e Kuvendit, ku ai do të paraqesë një Informatë për punën 100 - ditëshe të Qeverisë dhe Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008 – 2011.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta arsyetojë kërkesën e Kryeministrit.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me Programin e Qeverisë, që ia kishte dërguar Kuvendit ditë më parë, i cili duhet të paraqitet para deputetëve.

Ndërkohë, Qeveria ka përgatitur edhe Informatën lidhur me punën e saj 100 - ditëshe, e cila po ashtu duhet të paraqitet para deputetëve të Kuvendit.

Sabri Hamiti propozoi që fjalimi i Presidentit për gjendjen e përgjithshme në vend, Informata për punën 100 – ditëshe të Qeverisë dhe Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008 – 2011 të shqyrtohen në një seancë të veçantë të Kuvendit.

Naim Maloku propozoi që shqyrtimi i Programit të Qeverisë për periudhën 2008-2011 dhe Informata për punën 100 - ditëshe të Qeverisë të shtyhen për një seancë tjetër të radhës, me arsyetimin se deputetëve u duhet kohë që ato të analizohen para se të shqyrtohen në Kuvend.

Ibrahim Gashi mbështeti propozimin e parafolësit të tij që shqyrtimi i dy pikave të propozuara nga Qeveria të shtyhet për një javë, në mënyrë që deputetët të kenë më shumë kohë për ta analizuar Programin e Qeverisë.

Slobodan Petroviq tha se e përkrah propozimin që Informata dhe Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008 – 2011 të shqyrtohen në seancën plenare më 18 prill 2008.

Xhezair Murati mbështeti propozimin që Informata për punën 100 - ditëshe të Qeverisë dhe Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008 – 2011 të shqyrtohen në seancën plenare më 18 prill 2008.

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se mbështet propozimin që seanca e rregullt, me pikat që janë paraparë, të mbahet më 17 prill, ndërsa fjalimi i Presidentit për gjendjen e përgjithshme në vend, Informata dhe Programi i Qeverisë të jenë në seancë të veçantë, më 18 prill 2008.

Bojan Sotjaneviq, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, mbështeti propozimin e parafolësve që fjalimi i Presidentit për gjendjen e përgjithshme në vend, Informata dhe Programi i Qeverisë të jenë në seancë të veçantë, më 18 prill 2008.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me propozimet e cekura më lart, **vendosi** që seanca e rregull të mbahet më 17 prill 2008, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sporte,
4. Shqyrtimi parë i Projektligjit për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera,
5. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndërmjetësim.

Seanca tjetër e radhës të mbahet më 18 prill 2008, në orën 11:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Fjala e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me gjendjen e përgjithshme në vend,
2. Informata për punën 100 - ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008-2011.

3. Të ndryshme:

- 3.1 Njoftimi me vendimin e Qeverisë për caktimin e zëvendëskryeministrit, Ramë Manaj, për t'i koordinuar punët ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit**

Kryetari informoi anëtarët e Kryesisë se Qeveria ka caktuar zëvendëskryeministrin, Ramë Manaj, si përfaqësues të Qeverisë për t'i koordinuar punët ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit.

3.2 Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me auditimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin fiskal 2006

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se Zyra Auditorit të Përgjithshëm, në bazë të nenit 3.2 dhe 3.15 të Rregullores për themelimin e Auditorit të Përgjithshëm, i ka dërguar Kuvendit raportin vjetor.

Kryesia vendosi që Raporti t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit, për informim.

3.3 Njoftimi me urgjencën e UNMIK-ut për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, përmes UNMIK-ut ka kërkuar emërimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka propozuar emrat e kandidatëve për Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, nxori këtë

P e r f u n d i m

1. Kërkohe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që konform nenit 96.4 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë, të caktojë tre gjyqtarë për formimin e organit përzgjedhës të pavarur, i cili do të bëjë përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.
2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet që në afatin sa më të shkurtër t'i paraqesë Kryesisë së Kuvendit përbërjen e organit përzgjedhës të pavarur në mënyrë që të procedohet me rekomandimet e Qeverisë.

3.4 Njoftimi me kërkesën e (përsëritur) Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRE) lidhur me emërimin e dy anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me kërkesën e përsëritur të ZRE-së dërguar Kuvendit lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Kryesia e Kuvendit, më 21 shkurt 2008 ka kërkuar nga Qeveria që t'ia propozojë Kuvendit emrat e kandidatëve për anëtarë të Bordit të ZRE-së. Qeveria akoma nuk është përgjigjur në kërkesën e Kryesisë.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, nxori këtë

P e r f u n d i m

Kërkohe nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që bazë të autorizimeve që dalin nga Ligji për Rregullatorin të Energjisë, **urgjentisht** t'ia propozojë Kuvendit emrat e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

3.5 Njoftimi me Kalendarin e Punës së Kuvendit për muajin prill 2008 (çështjet e parapara për shqyrtim)

Kryesia u njoftua me Kalendarin e Punës së Kuvendit për muajin prill 2008 dhe vendosi që Kalendarin në fjalë t'ua shpërndajë të gjithë deputetëve.

3.6 Caktimi i Komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitat e shpallura sipas konkursit të datës 18 mars 2008

Kryetari informoi Kryesinë se Administrata e Kuvendit ka shpallur konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës. Konkursi është mbyllur dhe duhet të fillojë formimi i Komisionit intervistues, në pajtim me rregullat statusore të zyrtarëve civilë në Kuvendin e Kosovës.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me caktimin e komisionit të cekur më lart, nxori këtë

P e r f u n d i m

Kërkohet nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit: Naim Maloku dhe Eqrem Kryeziut që në bashkëpunim me sekretarin e Kuvendit t'ia paraqesin Kryesisë së Kuvendit propozimvendimin për përbërjen e Komisionit intervistues për përzgjedhjen e kandidatëve për të gjitha pozitat e shpallura sipas konkursit të datës 18 mars 2008.

3.7 Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e një anëtari të Komisionit për Punë Jashtme

Kryesia vendosi që propozimi i GP të SLS-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Punë të Jashtme të radhitet për shqyrtim në seancën plenare më 17 prillit 2008.

3.8 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Bojan Stojanović për lejimin e udhëtimit jashtë vendit

Kryesia i autorizoi dy anëtarët e saj, përgjigjës për shqyrtimin e kërkesave të deputetëve, dhe sekretarin e Kuvendit, që ta shqyrtojnë arsyeshmërinë e kërkesës së deputetit Stojanović dhe të vendosin në përputhje me vendimin e Kryesisë për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:10.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale